



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/81
Datë: 10.09.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 shtator 2009, mori

V E N D I M

1. Miratohet ekstrakti i procesverbalit dhe transkripti nga mbledhja e 80 e Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/81
Datë: 10.09.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 të Ligjit për Energjinë Nr. 2004/8, si dhe nenit 4 pika 3 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 10 shtator 2009, mori

V E N D I M

1. Miratohet Strategjia e Energjisë për periudhën 2009 - 2018 (Rishikimi i Strategjisë së Energjisë për periudhën 2005 - 2015).
2. Obligohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që Strategjinë e Energjisë për periudhën 2009 - 2018 nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/81
Datë: 10.09.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 03/L - 048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit, si dhe nenit 4 pika 3 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 10 shtator 2009, mori

V E N D I M

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMI TË QEVERISË NR. 07/63, TË DATËS
07.05.2009.

1. Ndryshohet dhe plotësohet vendimi i Qeverisë Nr. 07/63, i datës 07.05.2009.
2. Pika 1. e vendimit Nr. 07/63, në kolonën me numër rendor 4. të tabelës, ndryshohet shuma nga 300.000 (treqind mijë) euro, në 225.000 (dyqindnjëzetë e pesëmijë) euro.
3. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/81
Datë: 10.09.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe nenit 4 pika 3 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 10 shtator 2009, mori

V E N D I M

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMI TË QEVERISË NR. 10/77, TË DATËS
10.08.2009.

1. Ndryshohet dhe plotësohet vendimi i Qeverisë Nr. 10/77, i datës 10.08.2009.
2. Pika 2. e vendimit Nr. 10/77, zëvendësohet në tërësi si në vijim:

“Mjetet financiare sipas pikës 1. të këtij vendimi ndahen nga shpenzimet e paparashikuara të Qeverisë, kategoria ekonomike “shpenzime kapitale” dhe barten në kategorinë ekonomike “shpenzimet kapitale” të Komunës së Suharekës, kodi organizativ 624, kodi i programit 180-18012-0451, infrastrukturë rrugore”.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/81
Datë: 10.09.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe nenit 4 pika 3 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 10 shtator 2009, mori

V E N D I M

1. Mbështetet kërkesa e Shoqatës së të Verbërve dhe me të Parë të Dobësuar të Kosovës dhe Komitetit të Grave të Verbra të Kosovës.
2. Për dy projektet e prezantuara nga këto organizata ndahen mjetet financiare në vlerë prej 7.500 (shtatë mijë e pesëqind) euro, të cilat do të sigurohen nga rezervat "shpenzimet e parashikuara" të Qeverisë, dhe barten në kategorinë "subvencione" në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.
1. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/81
Datë: 10.09.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe nenit 4 pika 3 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 10 shtator 2009, mori

V E N D I M

1. Miratohet Strategjia Shtetërore e Republikës së Kosovës për Migracion dhe Planit i Veprimit.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet tjera të përfshira në zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit, të përcaktuar në pikën 1. të këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THACI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/81

Datë: 10.09.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 shtator 2009, mori

V E N D I M

1. Miratohet Projektligji për Mërgatën e Kosovës.
2. Obligohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/81

Datë: 10.09.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 13 të Ligjit për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 shtator 2009, mori

V E N D I M

1. Komisioni i Pavarur për rishikimin e kurrikulave dhe teksteve shkollore serbe për përdorim në territorin e Republikës së Kosovës, do t'i rishikojë kurrikulat dhe tekstet shkollore në gjuhën serbe për të siguruar pajtueshmërinë e tyre me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Kornizën e Kurrikulumit të Kosovës. Detajet e angazhimit do të vendosen në Planin e Veprimit të Komisionit.
2. Komisioni i Pavarur për punën e tij do t'i raportojë Ministrit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar çdo 6 (gjashtë) muaj, ndërsa do të dorëzojë tek ata një raport formal me shkrim në baza vjetore.
3. Për të siguruar mbarëvajtjen e punës së Komisionit të Pavarur në fazën fillestare, do të sigurohen mjete financiare në vlerë prej 100.000 (njëqindmijë) euro. Burimi financiar i këtyre mjeteve do të përcaktohet nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/81
Datë: 10.09.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe nenit 4 pika 3 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 10 shtator 2009, mori

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej 25.174 (njëzetepesëmijë e njëqindeshtatëdhjetekatër) euro për nder të 28 shtatorit, ditës së boshnjakëve.
2. Mjetet financiare sipas pikës 1. të këtij vendimi ndahen nga rezervat "shpenzimet e paparashikuara" të Qeverisë dhe barten në llogarinë bankare të Koalicionit "Vakat" Nr : 1404000003860532 - Banka Ekonomike.
3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë